

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

**Blerje automjete frigoriferike për transport mallrash**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): – 3410000-8,  
34136000-9, 34136100-0.**

**VLERA E FONDIT LIMIT: – 7 975 000 (shtatë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë  
mijë) lekë pa T.V.SH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;*
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

## 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. OE duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve vjetore të paraqitura pranë autoriteteve tatimore perkatese për vitet financiare 2021, 2022 ku bilancet e kërkuar nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

*(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht nënenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Përtatiminmbi të ardhurat" indryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Përkontabilitetin dhe pasqyratfinanciare”.

*(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).*

2.2.2. Vërtetim nga organet tatimore, për xhiron vjetore për 2 vitet e fundit financiare 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, ato i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të Operatorëve Ekonomik dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

---

Nëpërcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

---

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Përtatiminmbi të ardhurat", indryshuar, Udhëzimit të

---

Adresa: Rruga “Barrikadave”, Kodi Postar 1001, tel.:+355 42222991, ëeb: femijetetiranes.al, email:femijet@tirana.al

Ministrinë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Përtatiminmbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Përdeklarimin e detyrueshëm të deklaratavetatimore dhe të dokumenteve të tjeratimore, vetëmnëpërmjetformeselektronike".

*(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).*

### **Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë deshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryeragjate 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në njevlere jo më të vogël se 20% e vlerës së perlllogaritur të kontratës, qeprokurohet dhe qeeshterealizuar gjatetreviteve të fundit.

- Operatoriekonomik për të vertetuarpervojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat, sasishtë dhe llojin e mallrave të furnizuara.
- OperatoriEkonomik për të vertetuarpervojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat, sasishtë dhe llojin e mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanëpërvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së se perlllogariturtëkontrates,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar nenit 55 pika 4 gërma b e VKM nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" është përcaktuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së perlllogariturtëkontrates, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

---

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

2.3.2 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Liçensë për ushtrimin e aktivitetit të lëshuar nga QKB:

**Kategoria:** “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale të lidhura me transportin rrugor”.

**Nënkategoria:** “Shitblerja e mjeteve rrugore me motor dhe/ose e rimorkiove te reja ose te perdorura”.

**Kodi:** VII.3.B.2

**Argumentim:** - *Kërkesa që OE duhet të jetë i pajisur me Liçensë për ushtrimin e aktivitetit të lëshuar nga QKB: Kategoria: “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale të lidhura me transportin rrugor”, Nënkategoria: “Shitblerja e mjeteve rrugore me motor dhe/ose e rimorkiove te reja ose te perdorura”, Kodi: VII.3.B.2, është vendosur në zbatim të Ligjit nr. 9573, datë 03.07.2006, “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”, VKM Nr. 107, datë 10.02.2016, “Për një shtesë në VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar, Udhezimit nr. 1545, dt, 29.03.2016, “Shitblerja e mjeteve rrugore me motor dhe /ose rimorkiove të reja ose të përdorura, te autorizuar nga prodhuesi”.*

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet te jetë pajisur me Çertifikaten ISO 9001-2015 ose ekuivalente me të, lidhur me sistemin e menaxhimit te cilesise, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme, e leshuar nga nje organ i akredituar.

**Argumentim:** *Kërkesa që Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me çertifikatën ISO 9001:2015, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, konsiston në kërkesën që OE konkurues duhet të sigurojë mbi cilësinë e automjeteve të ofruara.*

2.3.4 OE duhet të paraqesë Garanci të Automjetit jo më pak se 100.000 km ose 2 vite përdorim nga moment i levrimit (cila prej tyre do arrihet e para). OE duhet të deklaroje kushtet teknike te garancise dhe sherbimet e perfshira brenda periudhes se garancise.

**Argumentim:** *Kërkesa që OE duhet të paraqesë Garanci të Automjetit jo më pak se 100.000 km ose 2 vite përdorim nga moment i levrimit (cila do arrihet e para) dhe se OE duhet të deklaroje kushtet teknike te garancise dhe sherbimet e perfshira brenda periudhës së garancisë është hartuar me qëllim që AK të sigurohet që mjetet nuk do të pësojnë defekte në një periudhë të afërt dhe përgjegjësinë për mjetet në këtë periudhë ta ketë OE. Në rast se kjo do të ndodhë, duhet të jenë të përcaktuara saktësisht kushtet dhe zërat përkatës mbi të cilat është e vlefshme garancia.*

2.3.5 OE duhet të garantoje servis te specializuar per riparimin e automjetit. Për këtë OE duhet të paraqesë një vetdeklarim ku të deklaroje se disponon në pronësi ose në përdorim servis, për

gjithë periudhën e garancisë së automjetit, i cili disponon liçencë për ushtrimin e aktivitetit të lëshuar nga QKB, si më poshtë:

**Kategoria:**“Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale të lidhura me transportin rrugor”.

**Nënkategoria:** “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”.

**Kodi:** VII.3.B.1

Operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë dokumentat provuese për vetdeklarimin e sipërpërmendur (dokumentat e pronësisë/kontratës së përdorimit, si dhe licencën përkatëse).

***Argumentim:**Referuar kërkesës për paraqitjen e garancisë është vendosur edhe kërkesa që OE duhet të garantojë servis të specializuar për riparimin e automjetit si dhe të deklarojë servis ku do të kryhen shërbimet. Për servis duhet të paraqesë: Liçensë për ushtrimin e aktivitetit të lëshuar nga QKB: Kategoria: “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale të lidhura me transportin rrugor”. Nënkategoria: “Autoriparimi I mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”. Kodi: VII.3.B.1. Nëpërmjet kësaj kërkesë AK do të sigurohet që shërbimet e përfshira në garancinë e deklaruar nga OE do të kryhen në një operator të specializuar për këtë aktivitet.*

2.3.6 OE duhet të paraqesë **Certifikat e Konformitetit të ngjashme** me mallinqeshitet.

***Argumentim:**Për të garantuar që automjeti është prodhuar conform standardeve të kërkuara, kërkohet që OE duhet të paraqesë Certifikatën e Konformitetit të prodhuesit për automjetin e ofruar. Për arsye se Certifikata e Konformitetit nga prodhuesi për automjetin hartohet pasi automjeti të jetë prodhuar, është kërkuar që OE konkurrues duhet që të paraqesë një Certifikatë Konformiteti të ngjashme (të një automjetitjetër, që ai aktualisht e disponon), në mënyrë që AK të sigurohet që OE konkurrues zbaton procedurat standarde për tregëtimin e automjeteve të reja. Certifikata e konformitetit për automjetin e ofruar do të paraqitet nga OE kontraktorsë bashku me automjetin në momentin e lëvrimin.*

2.3.7 OE duhet të deklarojë se disponon minimalisht një specialist teknik të specializuar/ diplomuar në inxhinieri mekanike për mjetet e transportit, për të garantuar plotësimin e detyrimeve të kontratës.

Operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë listë pagesen e deklaruar përmes formës elektronike.

***Argumentim:**Kriteri që OE duhet të ketë minimalisht një specialist teknik të specializuar/ diplomuar në inxhinieri mekanike për mjetet e transportit, është vendosur për të garantuar plotësimin e detyrimeve të kontratës.*

2.3.8 OE konkurrues duhet të paraqesë katalogun e automjetit, ose pjesë të shkëputura nga katalogu, ku të tregohet tipi i automjetit dhe parametrat e kërkuar të tij në specifikimet teknike.

*Argumentim:* Kriteri që OE konkurues duhet të paraqesë katalogun e automjetit, ose pjesë të shkëputura nga katalogu është vendosur që AK të vlerësojë që automjeti i ofruar plotëson parametrat e kërkuara në specifikimet teknike.

2.3.9 OE duhet te paraqese **Çertifikat e Konformitetit të ngjashme** për sistemin frigoriferik.

*Argumentim:* Sikurse edhe në kërkesat për automjetet, OE për sistemin frigoriferik duhet të paraqesë Certifikatën e Konformitetit të prodhuesit për Sistemin frigoriferik të montuar. Për arsye se Certifikata e Konformitetit nga prodhuesi për Sistemin frigoriferik hartohet pasi Sistemi frigoriferik të jetë prodhuar, është kërkuar që OE konkurues duhet që të paraqesë një Certifikatë Konformiteti të ngjashme (të një Sistemi frigoriferik tjetër, që ai aktualisht e disponon), në mënyrë që AK të sigurohet që OE konkurues zbaton procedurat standard për prodhimin e Sistemeve frigoriferikë. Certifikata e konformitetit për Sistemin frigoriferik të automjetit do të paraqitet nga OE kontraktor sëbashku me automjetin në momentin e lëvrimit.

2.3.10 OE konkurues duhet të paraqesë informacion të plotë mbi të dhënat teknike të sistemit frigoriferik (pasaportë teknike dhe/ose pjesë të katalogut ku përcaktohen parametrat teknikë, dhe /ose çdo dokument tjetër që jep informacion të plotë për parametrat teknikë).

*Argumentim:* Kriteri që OE konkurues duhet të paraqesë informacion të plotë mbi të dhënat teknike të sistemit frigoriferik, është vendosur që OE të tregojë dhe të garratojë që sistemi frigoriferik plotëson të gjitha kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike.

2.3.11 OE duhet të paraqesë Garanci për Sistemin frigoriferik, jo më pak se 2 vite përdorim nga moment i levrimit. Gjithashtu OE duhet të deklarojë kushtet teknike te garancise dhe shërbimet e përfshira përgjatë gjithë periudhës së saj.

*Argumentim:* Kriteri që OE duhet të paraqesë Garanci për Sistemin frigoriferik, jo më pak se 2 vite përdorim nga moment i levrimit është vendosur për arsyen se OE duhet të garantojë funksionimin pa problem të sistemit frigoriferik të automjeti të ofruar, për një periudhë kohe prej 2 vitesh si dhe duhet të deklarojë kushtet teknike te garancise dhe shërbimet e përfshira brenda periudhës se garancise.

2.3.12 OE duhet te paraqesë një vetdeklarim ku të garantojë servis te specializuar per riparimin e sistemit frigoriferik, si dhe te deklarojë servisin ku do të kryhen shërbimet e sistemit frigoriferik, përgjatë gjithë periudhës së garancisë.

Operatori ekonomik i klasifikuar i pari, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit** duhet të paraqesë dokumentat provuese për vetdeklarimin e sipërpërmendur (dokumentat e pronësisë ose kontratë bashkëpunimi, licencën përkatëse dhe/ose çdo dokument tjetër që vërteton se servisi është i specializuar për kryerjen e shërbimeve të sistemit frigoriferik).

**Argumentim:** Për plotësimin e këtij kriteri, OE duhet te garantojë servis të specializuar për riparimin e sistemit frigoriferik si dhe te deklarojë servis ku do të kryhen shërbimet, me qëllim që AK të sigurohet që OE i disponon të gjitha kapacitetet për riparimin dhe kryerjen e shërbimeve të sistemit frigoriferik.

## **II. Argumentim për hartimin e specifikimeve teknike:**

Argumentim mbi hartimin e specifikimeve teknike:

*Për hartimin e specifikimeve teknike të automjeteve frigoriferike, komisioni i është referuar specifikave respektive në raport me natyrën e aktivitetit që furgonat kryejnë, kapacitetin e mallrave që duhet të transportojnë, plotësimin e standardeve higjienosanitare për transportin e produkteve ushqimore si dhe destinacionet respektive që automjetet parashikohet të përshkojnë, në varësi të specifikave të rrugës që ato përshkojnë për të transportuar produktet pranë secilit prej çerdheve apo kopshteve.*

*Për përcaktimin e parametrave për automjetet e kërkuara, komisioni i është referuar informacioneve që gjenden lehtësisht në internet mbi parametrat dhe kapacitetet e mundshme të mjeteve të markave të ndryshme.*

*Parametrat e përcaktuara për automjetin e transportit me kapacitet 10-13 m<sup>3</sup>, janë vendosur duke patur parasysh se ky automjet do të jetë në shërbim të AK në destinacione të përcaktuara për shpërndarje produktesh ushqimore në sasi të madhe për të përballuar furnizimin për rreth 15-20 kopshte dhe çerdhe.*

*Ndërsa parametrat e përcaktuara për automjetin e transportit me kapacitet 3-3.5 m<sup>3</sup> janë vendosur duke patur parasysh se ky automjet do të jetë në shërbim të AK në destinacione të përcaktuara për shpërndarje produktesh ushqimore në sasi më të vogël për të përballuar furnizimin e çerdheve me frekuentim të ulët në distanca të largëta, duke krijuar kështu lehtësi në transport në funksion të kursimit të kohës dhe karburantit.*

*Duke qenë se institucioni ynë disponon aktualisht automjete frigoriferikë ATV të markave të ndryshme, Komisioni iu është referuar specifikave dhe parametrave të tyre, duke përcaktuar segmente parametrash dhe përmasash gjithëpërfshirëse, duke përcaktuar parametra maksimale dhe minimale të cilat plotësojnë kërkesat e institucionit në raport me aktivitetin funksional që këto automjete do të kryejnë.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*